



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	08.11.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SHKREJTI	6946	2023	1/13



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1206/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti, anëtarë; me Avdyl Bekteshi, Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1206/2023, të datës 25.09.2023, të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson avokat nga Prishtina, kundër Vendimit KD.nr.04/2023, të datës 24.08.2023, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, në çështjen juridike “*masë disiplinore-largim nga shërbimi civil*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.11.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1206/2023, e datës 25.09.2023, e parashtruar nga ankuesja

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi KD.Nr.04/2023, i datës 24.08.2023, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë.

**A r s y e t i m**

Nëpunësja civile (tutje referuar ankuesja), më datë 25.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.Nr.04/2023 të datës 24.08.2023, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar Këshilli) bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e



Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Ministrinë e Drejtësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 10.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshëm në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 6247/2023, të datës 25.09.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin për përfaqësim të datës 01.09.2023; Vendimin KD.nr.04/2023 të datës 24.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Procesverbalin e datës 28.07.2023 i Komisionit Disiplinor; Shkresë përcjellës për Komisionin Disiplinor e datës 13.07.2023; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore me numër protokolli 10 e datës 13.07.2023; Plotësimin e ankesës datë 06.10.2023 nga ankuesja; Vendimin e datës 30.03.2023 të Këshillit dhe Raportin e Monitorimit për vitin 2020 në Ministrinë e Drejtësisë; e-mailin e datës 26.07.2023 nga ankuesja për [redacted], e-mailin e datës 18.11.2022 nga ankuesja për [redacted] e-mailin e datës 16.11.2022 nga [redacted] për ankuesen dhe të tjerët; Listën e rasateve të përgatitur nga ankuesja; Aktgjykimin Ac.nr.1732/2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.887/22 të datës 13.06.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; e-mailin e datës 25.07.2023 nga [redacted] për [redacted] e-mailin nga [redacted] për [redacted] Procesverbalin e shqyrtimit përgatitur i datës 20.03.2023; Procesverbalin për shqyrtimin kryesor i datës 20.03.2023, 15.11.2022; e-mailin e datës 08.03.2022 të ankueses; e-mailin e datës 14.12.2021 nga [redacted], Ekspertiza-Raport e datës 08.12.2020; Super Ekspertiza për Lëndën R.br.29/17; Kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë Tokë LRP-nr.rend.208/13, nr. Ref.93/13; Kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë Tokë LRP-nr.rend.460/13, nr. Ref.214/13; Kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë Tokë LRP-nr.rend.209/13, nr. Ref.94/13; e-mailin e datës 25.11.2020 nga [redacted] për [redacted] e-mailin e datës 24.11.2020 nga [redacted] për [redacted] dhe [redacted] e-mailin e datës 08.11.2021 nga [redacted] për [redacted] e-mailin e datës 13.10.2021 nga [redacted] për [redacted] dhe [redacted] e-mailin e datës 19.10.2021 nga [redacted] për [redacted] e-mailin e datës 15.10.2021 nga [redacted] për [redacted]; e-mailin e datës 09.09.2020 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 09.09.2021 nga [redacted] për [redacted] e-mailin e datës 17.11.2021 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 17.11.2021 nga [redacted] për [redacted] dhe [redacted] e-mailin e datës 25.10.2017 nga [redacted] për [redacted] dhe [redacted] Emailin e datës 25.10.2017 nga [redacted] për [redacted] dhe [redacted] e-mailin e datës 24.10.2017 nga [redacted] për [redacted] e-mailin e datës 19.11.2021 nga [redacted] për [redacted] e-mailin e datës 26.10.2021 nga [redacted] për [redacted] e-mailin e datës 15.07.2021 nga [redacted] për [redacted]; Aktvendim C.nr.18/15 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan; Aktvendim Ac.nr.3175/19 i Gjykatës së Apelit të Kosovës; e-mailin e datës 17.11.2021 nga [redacted] për [redacted] Aktvendimin C.nr.245/2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc; e-mailin e datës 26.07.2023 nga ankuesja për [redacted] dhe e-mailin e datës 13.07.2023 nga [redacted] për [redacted]; e-mailin e datës 13.07.2023 nga ankuesja për [redacted]; e-mailin e datës 12.07.2023 nga [redacted] për ankuesen; e-mailin e datës 25.05.2023 nga ankuesja për [redacted] e-mailin e datës 24.05.2023 nga [redacted] e-mailin e datës 31.05.2023 nga ankuesja për [redacted]; Aktvendim R.br.26/22; Procesverbal R.br.26/22; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 10.10.2023; Akt Emërimin e datës 03.11.2016 për ankuesen; Vendimin e datës 03.11.2016; Vendimin me Nr. 159/2016 i datës 18.10.2016; Konkursin e datës 27.06.2023 për Avokat Shtetëror; e-mailin e datës 12.07.2023 nga ankuesja për [redacted]; e-mailin e datës 12.07.2023 nga [redacted] për [redacted] ankuesen; e-mailin e datës 12.07.2023 nga [redacted] për [redacted] e-mailin e datës 12.07.2023 nga [redacted] për [redacted]



ankuesen dhe të tjerët; Emailin e datës 08.03.2023 nga për ankuesen; e-mailin e datës 27.04.2023 nga për ankuesen dhe të tjerët; e-mailin e datës 15.02.2023 nga për ankuesen dhe të tjerët; e-mailin e datës 02.02.2023 nga për , e-mailin e datës 11.05.2023 nga për ankuesen; e-mailin e datës 11.05.2023 nga për dhe Aktvendimin Cpc-56/23 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil; Urdhër për Përmbarim Cpc.nr.56/23 i darës 22.03.2023; Autorizim i datës 22.12.2016, 28.12.2016; Prokurë e veçantë e pakufizuar 14.11.2017; Provë për takim me ankuesen; e-mailin e datës 25.05.2023 nga për Listën e lëndëve të ndara; Vërtetim i datës 03.04.2023; Procesverbalin për shqyrtimin kryesor CN.nr.15/18 i datës 29..05.2023; Procesverbalin për shqyrtimin kryeso CN.nr.15/2018 i datës 05.06.2023; Vendim për pushim vjetor e datës 14.06.2023; Procesverbal i seancës kryesore CN.nr.27/21; Padi për anulimin e pajtimit gjyqësor dhe propozimin për masën e sigurisë nga Avokatura Shtetërore për Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Gllogoc; Aktvendimin C.nr.245/2023 i datës 07.07.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc; Vendimin me Nr. 23/2023 i datës 24.02.2023; Vendimin me Nr. 108 i datës 14.02.2023; Vendimin me Nr. 10-944/3 i datës 11.08.2023; Ftesë nga komisioni disiplinor e datës 20.07.2023 nga për ankuesen; Ftesë nga Komisioni Disiplinor e datës 21.07.2023 nga për Procesverbalet e Komisionit Disiplinorë datë 28.07.2023, ora 09:00, ora 14:10, ora 14:30, ora 13:30; Procesverbalin e datës 24.07.2023 të Komisionit Disiplinor; Lista e rasteve; Lias ta e ndarjes së lëndëve; Aktvendimin AC.nr.4850/2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktvendim C.nr.245/2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega Gllogoc; Vendimin KD.nr.8/2022 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë; Njoftimin nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës për zv. Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, si dhe bazuar në rezultatin e tërësishëm të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses, *sepse*:

Nga provat e administruara të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja është e punësuar në Avokaturën Shtetërore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, gjegjësisht e njëjta sipas Akt Emërimit të datës 03.11.2016, ka ushtruar pozitën e punës *Avokat Shtetëror*.

Tutje, sipas shkesave të lëndës rezulton së Zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshme Shtetërore, në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të ankueses, më datë 13.07.2023, ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankueses, me pretendimet se e njëjta ka bërë shkelje të rënda disiplinore dhe atë citojmë:

- Me dt. 27 prill 2023 me qëllim të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së punës nga Avokatët Shtetëror, kam kërkuar raportim javor për punën e avokatëve shtetëror ndërsa znj. nuk ka raportuar sipas kërkesës dhe obligimit ligjor kështu duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Avokaturën Shtetërore. Me dt. 8 maj e kam njoftuar prapë me e-mail se nuk kam pranuar raportin javor dhe i kam kërkuar që ti përmbahet udhëzimeve për raportim. E njëjta deri më tani asnjëherë nuk ka raportuar tek zv. Avokati i Përgjithshëm.
- Me datë 15 shkurt 2023 iu kam drejtuar me e-mail të gjithë avokatëve që çdo vendim të pranuar nga gjykata të iu përcillet organizatave buxhetore që i përfaqësojmë edhe pse të njëjtët e kanë obligim ligjor, por meqenëse ishte edhe gjetje e auditorit të përgjithshëm, që të kenë rikujtim për procedim të vendimeve. Me dt. 11 Maj 2023 Divizioni për Buxhet dhe Financa-Md z.



- e ka përcjell e-mailin nga Thesari i Kosovës/MFPT tek Avokatura Shtetërore, se lënda më numër 56/23, kreditor dhe debitor Ministria e Drejtësisë, është iniciuar në procedurë përmbartimore, duke kërkuar sqarim lidhur me pagesën. Me dt.11. maj po ne të njëjtën ditë i jam drejtuar me email znj. se a e ka përcjell vendimin e gjykatës tek Ministria e Drejtësisë - Shërbimi Korrektues i Kosovës. E njëjta nuk është përgjigjur fare në kërkesën time. Znj. nuk e ka njoftuar Md-SHKK fare me këtë vendim të formës së prerë andaj si pasojë SHKK nuk ka qenë në dijeni për obligimin ligjor, më rast pala paditëse ka iniciuar procedurë përmbartimore, me çka është janë shkaktuar shpenzime shtesë e si pasojë e mos ndërmarrjes së veprime ligjore dëmtohet buxheti i shtetit, duke mos vepruar sipas autorizimeve ligjore nga znj.
- Me datë 06 mars 2023 i kam ftuar në takim Avokatët Shtetëror ku kam kërkuar që tek lëndët e shpronësimit ( procedure jo kontetsimore), sa i për këtë ujdive gjyqësore që propozohet nga palët, ti përmbahen disa hapave para se të lidhin ujdive gjyqësore në këto lëndë. Kërkesa ka qenë ujdite mos të lidhen pa analizim dhe aprovim nga zv. AVPSH, zëvendësuesi i tij apo zyrtari tjetër i Departamentit të Shpronësimit. Po ashtu ujdive nuk mund të lidhet nga avokati që nuk është i ngarkuar me lëndën. Kjo së për shkak nga praktika ka pasur gabime në sipërfaqe të shpronësuar dhe ato të mbetura jashtë shpronësimit për shkak të shpronësimeve më shumë së një herë për ngastër të njëjta, po ashtu ka pasur lëshime sa i për rketë aplikimit të çmimeve të njëjta apo të përafërta të ngastrave kadastrale që gjenden në të njëjtën zonë kadastrale. Pas këtij takimi Znj. nuk e ka përfillur fare këtë kërkesë dhe ka vazhduar të lidhë ujdive pa asnjë analizim dhe aprovim nga zv.AVPSH apo Dep. i Shpronësimit, po ashtu duke lidh ujdive edhe për lëndët e avokatëve të tjerë. Ujdite që ka lidhur pa aprovim dhe analizim nga Zv AVPSH apo zyrtari kompetent i D.Sh janë: Nr. i lëndës 2019:114677 i datës 20.03.2023 (lëndë e av. ....); Nr. i lëndës 2022:145876 i dt.20.03.2023 (lëndë e av. ....). Nr. i lëndës 2019:144243 i dt.20.03.2023( lëndë e ....); Nr. i lëndës 2019: 139769 i dt.20.03.2023( lëndë e ....).
  - Përveç që i ka lidhur këto ujdive pa kurrfare aprovimi apo analizimi, e njëjta as pas lidhjes së tyre nuk i ka përcjell fare tek Departamenti i Shpronësimit për pagesë. .... Meqenëse e kam vërejtë së znj. nuk po i përmbahet udhëzimit si në takimin e fundit dhe më qëllim që të ketë edhe me shkrim kërkesën lidhur me lëndët e shpronësimit, me dt.27 Mars 2023, të gjithë avokatëve shtetëror iu kam drejtuar me email më kërkesa të njëjta si në takimin e fundit, që ujdite pa analizim dhe aprovim nuk mund të lidhen po ashtu lëndët kur zëvendësojnë koleget me rast të veçanta me autorizim nga Zv. AVPSH. ...
  - me datë 24 Maj 2023 përmes e-mailit nga Z. e kuptoj që e njëjta prap ka lidh vazhduar të lidh ujdive gjyqësore në Lëndën C.nr.26/22, duke mos qenë fare e njoftuar as pa analizim dhe pa aprovim, me c' rast ka bërë gabime edhe sa i për kete ngastrës meqenëse nuk është konsultuara me DSH sepse ajo ngastër ka pasur dy herë shpronësim që nënkupton së nuk ka pasur pjesë të pa shpronësuar. Për me shumë kjo lëndë i është ngarkuar i cili nuk ka qenë në njohuri së Znj. ka lidhur ujdive për lëndën e tij. E njëjta nuk e ka njoftuar as DSh për ujdinë /gjyqësor, ky Departament është njoftuar nga pala ku ka kërkuar ekzekutimin e ujdisë.....
  - me dt. 05 Qershor, znj, në lëndën C.nr.15/2018 ka lidhur ujdive për lëndën që është ngarkuar . e cila ka qenë në pushim,,,,...



- më datë 22 Qershor znj. ka pranuar Aktgjykimin A.nr.887/22 nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, me paditës dhe të paditur KPMSHCK dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Me këtë Aktgjykim detyrohet e paditura e dytë MPB që paditësit t'i kompensoj shumën në vlerë prej 6.765.93 euro. Znj. ketë aktgjykim nuk e ka përcjell tek MPB, po ashtu nuk ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit...
- me datë 12 Qershor 2023 në lëndës CN.nr.27/11, me propozues Znj. pas pasur aprovim as pa analizuar fare lëndën si për qasje në rrugë si nga pjesë e mbetur jashtë shpronësimit dhe vlera e ekspertizës, ka lidhur ujdë gjyqësore në shumë prej 505.000.00 euro si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 10.000.00 euro. Për këtë pajtim jam njoftuar nga gjyqtari i çështjes se përkundër faktit se Gjykata e ka aprovuar ujdinë sipas vullnetit të palëve ka kërkuar që të analizohet për shkak të lëshimeve eventuale e të cilat do ta dëmtonin buxhetin e shtetit. Pas analizimit të kësaj ujdie kemi vërejtur se kjo ujdë ka mospërputhshmëri të vlerësimit në mes të dy ekspertizave dhe ka dëm 100 % të sipërfaqes së pa shpronësuar, e cila pjesë e pronës edhe pas ujdisë nuk ka kaluar në emër të Qeverisë e as që është kërkuar nga znj. Me qellim që mos të shkaktohet dëm i pa riparueshëm i buxhetit me datë 6 Korrik 2023 kemi dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dega në Gllogoc, padi për anulim të Pajtitimit Gjyqësore dhe Propozim për caktimin e masës së sigurimit. Me datë 11 Korrik 2023 nga kjo Gjykatë kemi pranuar Aktvendimin C.nr.245/2023 me të cilin është aprovuar propozimi për masë dhe caktohet masa e përkohshme e sigurimit ashtu që ndalohet ekzekutimi i Pajtitimit Gjyqësor i dt.12.06.2023 në lëndën CN.nr.27/21.....

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme me Vendimin me numër protokolli KD.nr.04/2023 të datës 24.08.2023, ka bërë përgjegjëse ankuesen për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3, nën paragrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.7 dhe 3.10 të ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, duke i shqiptuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil".

Ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e Vendimit KD.nr.04/2023, të datës 24.08.2023, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, me pretendimet se: vendimi është nxjerr jashtë afatit prej 30 ditësh, ndërkaq, shtyrja e afatit për përfundimin e procedurës nuk ka plotësuar kushtet e parapara me nenin 99 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative; Komisioni Disiplinor në seancën e datës 28.07.2023 nuk ka ftuar edhe iniciuesin e procedurës disiplinore por vetëm ankuesen në mënyrë që të bëhet ballafaqimi i argumenteve; Komisioni Disiplinor për këtë rast është formuar në kundërshtim me Ligjin për Avokaturën Shtetërore konkretisht nenin 16; Përgatitja e raporteve nuk është detyrë e avokatëve shtetëror, por e zyrtarëve të data bazës sepse në data bazë regjistrohet çdo shkresë hyrëse dhe dalës e Avokaturës Shtetërore dhe mos raportimi i ankueses ka qenë lirimi nga puna teknike. Tutje, ankuesja pretendon së është i pabazuar dhe i kundërligjshëm përfundimi i Komisionit Disiplinor së ankuesja do të duhej që para së të lidhë ujdë gjyqësore të marrë aprovim nga Departamenti i Shpronësimit në Ministrinë e Financave, sepse avokati shtetëror në bazë të Ligjit për Procedurën Jokontestimore si dhe nenit 67, 68 dhe 70 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisive, nuk ka asnjë detyrim të pyes organin e shpronësimit për të lidhë ujdë gjyqësore dhe se në provat e lëndës ka dëshmi se Drejtori i Departamenti të Shpronësimit iu ka sugjeruar avokatëve që të gjitha lëndët e vjetra të shpronësimit të zgjidhjen me ujdë dhe të mos bëhet ankesë. Komisioni Disiplinor ka tejkalluar kompetencat duke lëshuar në vlerësimin e ligjshmërisë së



ujdive gjyqësorë, sepse vlerësimin e ligjshmërisë së ujdive gjyqësore e bënë vetëm gjykata kompetente (Gjykata Supreme). Kërkon që Këshilli të aprovoj në tërësi ankesën si të bazuar, të anulohet vendimi e kontestuar me ankesë dhe të obligoj Ministrinë e Drejtësisë të kthejë ankuesen në pozitën e saj të punës dhe të bëjë kompensimin e pagave të pa realizuara nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës si dhe të gjitha të drejtat e tjera nga marrëdhënia e punës.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë përgjegjësinë dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civile, me theks të veçantë:

Nenit 45 më të cilin është përcaktuar se: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”*.

Nenit 46, i cili trajton shkeljet disiplinore ku përcakton se: *“shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë”* ndërsa *“Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar”*.

Nenit 47 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se: *“Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”*.

Nenit 50 i cili ka përcaktuar se: *“1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit”*.



Mbi bazën e kuadrit ligjor si me lartë, Kolegji ka analizuar vendimin e atakuar më ankesë në ndërlidhje më pretendimet ankimore dhe provat materiale të çështjes, nga dhe ka konstatuar:

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se Vendimi KD.nr.04/2023 i datës 24.08.2023, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, është nxjerr jashtë afatit prej 30 ditësh dhe se për shtyrje të afatit për vendimmarrje nuk janë plotësuar kushtet e parapara me nenin 99 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit bazuar në shqyrtimin e shkresave të kësaj çështje administrative ka gjetur së zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshëm Shtetërorë kërkesën për inicim të procedurës disiplinore e ka parashtruar më datë 13.07.2023, dhe së po në të njëjtën ditë kërkesa i është dorëzuar Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore. Komisioni Disiplinor në seancën e datës 24.07.2023, ka aprovuar kërkesën e ankueses për afat shtesë, kërkesë të cilën ankuesja e mbështet në arsyetimin se lëndën e ka pranuar më vonesë dhe duke qenë së është voluminoze, kërkohet kohë për analizim. Mbi këtë shkak dhe për arsye të kompleksitetit të çështjes, Komisioni Disiplinor më Vendimin me numër protokollit 10-944/3 të datës 11.08.2023, ka shtyrë afatin për përfundimin e procedurës disiplinore edhe për 15 ditë. Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit duke bazuar në nenin 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, konstaton së Komisioni Disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës, mirëpo, në rastet kur lënda është komplekse ky afat mund të zgjatet në pajtim me kërkesat e përcaktuara me nenin 99 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku parashihet se: *Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligji, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji. 2. Shtyrja sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar procedurën administrative dhe duhet të jetë në përpjesëtim me kompleksitetin e çështjes konkrete, por nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar*”, kështu që, në këtë kuptim, Kolegji vlerëson së shtyrja e afatit për vendosje nga ana e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë është bërë në pajtim me dispozitat ligjore si më sipër, dhe së i njëjti ka nxjerrë vendim përfundimtar brenda afatit ligjor, andaj, nisur nga këto rrethana është i pabazuar pretendimi i ankueses mbi këtë bazë ankimore.

Referuar pretendimit ankimor të ankueses se Komisioni Disiplinor në seancën e datës 28.07.2023 nuk ka ftuar edhe iniciuesin e procedurës disiplinore, por vetëm ankuesen në mënyrë që të bëhet ballafaqimi i argumenteve, Kolegji nga shkresat e lëndës ka konstatuar se Komisioni Disiplinor ka ftuar në seancë dëgjimore ankuesen edhe iniciuesin e procedurës disiplinore, dhe së të dyja palëve ju është dhënë mundësia e deklaramit dhe argumentimit të fakteve, kështu që, nisur nga ky fakt rezulton së Komisioni Disiplinor ka vepruar në pajtim me nenin 12 paragrafët 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku përcaktohet se: *“Komisioni vlerëson faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit. 3. Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: 3.1. Merr në pyetje ose merr deklarata a dëshmitarët dhe verifikon faktet; 3.2. Rishikon dokumentacionin përkatës; 3.3. Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t’u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit; 3.4. Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes.*, rrjedhimisht nuk është i bazuar ky pretendim i ankueses.



Në ndërlidhje me pretendimin ankimor mbi bazën se Komisioni Disiplinor për këtë rast është formuar në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit për Avokaturën Shtetërore, Kolegji i Këshillit vë në dukje faktin se marrëdhënia e punës së nëpunësve civilë rregullohet me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe se i njëjti me dispozitat e nenit 85 ka shfuqizuar Ligjin për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës si dhe çdo dispozitë tjetër që në kundërshtim me këtë ligj. Gjegjësisht, referuar dispozitave të nenit 32 paragrafi 3 të të njëjtit ligj *Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji*. Andaj, mbi këtë bazë rrjedhë së me hyrjen në fuqi të Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk mund të vinë në zbatim dispozitat e nenit 16 të Ligjit Nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, qoftë në emërim apo edhe procedurë disiplinore të avokateve shtetëror, kështu që Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë i themeluar sipas Vendimit me Nr. 23/2023 të datës 24.02.2023, është kompetent për shqyrtimin dhe vendosjen e çështjes disiplinore, të iniciuar ndaj ankueses, sipas kërkesës së datës 13.07.2023, të Zëvendësueses së Avokatit të Përgjithshme Shtetërore.

Në kontekst të shkeljes disiplinore lidhur me mos raportim javor të punës nga ana e ankueses, Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave materiale të lëndës ka gjetur se më datë 27.04.2023, Zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, ka përcjell të të gjithë avokatët shtetërorë përfshirë edhe ankuesen, formën e raportimit javor të punës, më kërkesën e përbashkët që raporti javor i punës duhet të dërgohet çdo të premte deri në fund të orarit të punës, ndërsa, ankuesja nuk kishte vepruar sipas kësaj kërkesë, rrejdhimisht, ankuesja as në procedurë disiplinore, e po ashtu as në procedurë të ankesës, nuk ka ofruar dëshmi që provojnë së e njëjta kishte përgatitur raport javor të punës për periudhën kontestuese përkatësisht nga data e kërkesës së zëvendësues se Avokatit të Përgjithshme Shtetërorë (27.04.2023) deri në inicim të procedurës disiplinore (13.07.2023).

Për me tepër, se avokatet shtetëror kanë për detyrim raportimin javor të aktiviteteve të punës, është vërtetuar edhe nga dëshmitë e avokateve shtetëror dhe të dhëna pranë Komisionit Disiplinor, ku avokatja shtetërore ka konfirmuar së raporton në baza javore dhe së detyrimi për raportim e kanë pasur edhe me herët gjegjësisht se kërkesa për përgatitje të raporteve javore ka qenë edhe para Avokatit aktuale të Përgjithshme Shtetëror, ndërsa, avokati shtetëror ka theksuar se Zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshme Shtetërore më datë 27.04.2023 kishte kërkuar përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve javore të punës, kështu që mbi këto fakte, mos veprimi i ankueses sipas kërkesës së mbikëqyrës së drejtpërdrejte për raportim javor të punës gjegjësisht mos raportimi javor i punëve nga ana e ankueses, edhe përkundër kërkesës më shkrim të Zëvendës Avokates së Përgjithshme Shtetërore në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejt të ankueses, janë veprime në kundërshtim me përgjegjësitë e ankueses të përcaktuara me nenin 10 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-157 Për Avokaturën Shtetërore me të cilin është përcaktuar se : *Avokatët shtetëror e informojnë Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror për gjendjen e përfaqësimit të lëndëve*”.

Në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, nuk qëndron arsyetimi i ankueses si në ankesë se *mos përgatitja e raporteve të punës, nuk është detyrë e avokatëve shtetëror, por e zyrtarëve të data bazës sepse në data bazë regjistrohet çdo shkresë hyrëse dhe dalës e Avokaturës Shtetërore dhe mos raportimi i ankueses ka qenë lirimi nga puna teknike, sepse raportimi i aktiviteteve të realizuara, është pjesë e detyrave të punës për çdo nëpunës civil dhe së i njëjti duhet të përgatis raporte të punës në baza kohore të përcaktuara nga mbikëqyrësit apo titullari i institucionit.*



Referuar shkeljes disiplinore të ankueses përkitazi me lidhjen e ujdive gjyqësore pa analizimin dhe aprovim paraprak nga Zëvendësuesja e Avokates së Përgjithshme Shtetërore apo zyrtari i caktuar nga Departamenti për Shpronësim, Kolegji nga analizimi i shkresave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se Zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror me datë 06.03.2023, kishte ftuar në takim të gjithë avokatët shtetëror, duke kërkuar nga këta të fundit që para lidhjes së ujdive gjyqësore të behët analizimi dhe miratimi paraprak nga ana e Zëvendësues se Avokates së Përgjithshme Shtetërore, fakt ky i konfirmuar nga vet ankuesja dhe dëshmitarët e dëgjuar në seancë pranë Komisionit Disiplinor. Tutje, rrjedhë së Zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshme Shtetërore sërish me datë 27.03.2023, ka përcjell përmes e-mailit kërkesën dhe udhëzimin për të gjithë avokatet shtetëror me tekstin citojmë: *para së të lidhen ujdite gjyqësore duhet të ndërmerren disa hapa, dhe meqë kam vërejtur se në disa rase nuk ju keni përmbajtur udhëzimeve të njëjta, kërkesat po i përcjell përmes emailit: Së paku një javë para seancës të adresohet me e-mail te zv. AVPSH, kërkesa për shqyrtim të arritjes së ujdisë, duke dhënë sqarime detajisht për lëndë, konkrete si dhe duke e sjellë lëndën fizike; Ujdia nuk mund të lidhet pa aprovim paraprak të zv.AVPSH apo zëvendësuesit të tij, apo ledhe nga zyrtari përgjegjës i Departamentit të Shpronësimit; Ujdia nuk mund të lidhet nga avokati që nuk është i ngarkuar me lëndë, vetëm në rastet kur paraprakisht njoftohet zv. AVPSH dhe jepet arsyetimi, e më pas zv. AVPSH e autorizim apo refuzon një veprim të tillë.* Në kontekst të kësaj, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka konstatuar së ankuesja edhe pas kërkesës gojore të datës 06.03.2023 dhe kërkesës më shkrim të datës 27.03.2023 të Zëvendësues së Avokates së Përgjithshme Shtetërore, ka vazhduar me lidhjen e ujdive gjyqësore pa analizim dhe miratim paraprak të Zëvendësues së Avokatit të Përgjithshme Shtetërore, apo nga zyrtari përgjegjës i Departamentit të Shpronësimit, dhe atë: sipas Procesverbalit për Shqyrtim Përgatitor, në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, në çështjen civile me numër të lëndës 2019:114677, të datës 20.03.2023, propozues kundërpropozues Qeveria e Kosovës, ankuesja në cilësi të përfaqësueses së Qeverisë së Kosovës ka arritur pajtim gjyqësorë me propozuesin, ashtu që Qeveria e Kosovës-Organi i Shpronësimit t'i bëjë pagesën propozuesit në shumë prej 22.770,00 Eurove në emër të diferencës për pjesën e shpronësuar si dhe shpenzimet e procedurës jokontestimore në shumë prej 1800,00 Eurove; sipas Procesverbalit për Shqyrtim Përgatitor, në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, në çështjen civile me numër të lëndës 2019:145876 të datës 20.03.2023, propozues kundërpropozues Qeveria e Kosovës-Organi Shpronësues, ankuesja si përfaqësuese shtetërore ka arritur pajtim gjyqësorë me propozuesin, në mënyrë që Qeveria e Kosovës-Organi i Shpronësimit të bëjë pagesën për prozuesin në shumë prej 121,295.00 Euro në emër të diferencës për pjesën e shpronësuar si dhe shpenzimet e procedurës jo kontestimore në shumë prej 2,360.00 Euro; sipas Procesverbalit për Shqyrtim Përgatitor, në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, në çështjen civile, me numër të lëndës 2019:144243 të datës 20.03.2023, propozues kundërprozues Qeveria e Kosovës, ankuesja ka arritur pajtim gjyqësorë me propozuesin, me objekt pajtimi që Qeveria e Kosovës-Organi i Shpronësimit të bëjë pagesën e shumës prej 186,213, 00 Euro, në emër të diferencës për pjesën e shpronësuar si dhe shpenzimet e procedurës jokontestimore në shumë prej 3.000 Euro; sipas Procesverbalit për Shqyrtim Përgatitor, në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, në çështjen civile, me numër të lëndës 2019:139769 të datës 20.03.2023, propozues kundërpropozues Qeveria e Kosovës, ankuesja ka arritur pajtim gjyqësorë me propozuesin, në mënyrë që Qeveria e Kosovës-Organi i Shpronësimit të bëjë pagesën e shumës prej



20.237,00 Euro, në emër të diferencës për pjesën e shpronësuar si dhe shpenzimet e procedurës jokontestimore në shumë prej 1,530.00 Euro; sipas Procesverbalit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në çështjen civile C.nr.26/22, të datës 03.04.2023, propozues kundërpropozues Qeveria e Kosovës, ankuesja ka arrit pajtim gjyqësor me propozuesin, ashtu që Qeveria e Kosovës- Departamenti i Shpronësimit të bëjë pagesën për propozuesin në shumë totale prej 165.654.00 Euro €; sipas Procesverbalit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Dega e Gjykatës në Kaçanik, në çështjen civile C.nr.15/2018, numër të lëndës 2019:145676 të datës 05.06.2023 propozues kundërpropozues Qeveria e Kosovës, ankuesja ka lidh pajtim/ujdi gjyqësore me propozuesin, ashtu që Qeveria e Kosovës- Departamenti i Shpronësimit ti paguaj propozuesit vlerën prej 45.828.00 €, në emër të diferencës për pjesën e shpronësuar dhe dëmit të pësuar, si dhe shpenzimet e procedurës jokontestimore në shumën prej 1.668.00 Euro; sipas Procesverbalit në çështjen civile CN.nr.27/21 të datës 12.06.2023, propozues kundërpropozues Qeveria e Kosovës, ankuesja ka arrit marrëveshje me propozuesin në ate mënyrë që Qeveria e Kosovës propozuesit ti paguaj në emër të shpronësimit të pasurisë së paluajtshme, si dhe dëmin e shkaktuar në vlerë prej 505.000.00 Euro.

Rrjedhimisht, lidhur me kërkesën e Zëvendësuese së Avokates së Përgjithshme Shtetërore që ujdite gjyqësore nuk mund të lidhen nga avokati shtetëror qe nuk është i ngarkuar, Kolegji nga deklaratat e dëshmitarëve pranë Komisionit Disiplinor ka gjetur së avokatët shtetëror për arsye të ekonomizimit dhe numrit të madhe të lëndëve janë dakorduar që seancat ti ndajnë në bazë të territoreve përkatësisht një avokat merr lëndët në një qytet, ndërsa avokati tjetër në një qytetet tjetër, kështu që mbi këtë fakt ankuesja ka përfaqësuar në çështjen Cn.nr.15/2018, në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik edhe pse lënda ishte ngarkuar në emër të avokates shtetërore fakt ky që në vlerësimin e Kolegjit nuk është kontestues dhe nuk përbën tejkalim të detyrave të punës, mirëpo, kontestuese është fakti se ankuesja me rastin e lidhjes së ujdisë gjyqësore në këtë çështje civile nuk kishte marr aprovim paraprak të Zëvendësueses së Avokates së Përgjithshme Shtetërore/zëvendësuesit të tij, apo nga zyrtari përgjegjës i Departamentit të Shpronësimit, e të cilin mos miratim ankuesja e arsyeton se: *do të vazhdoj me lidhjen e ujdive gjyqësore pasi që kjo është ligjërish në të mirën e buxhetit të Republikës së Kosovës dhe kur bënë mirë nuk jeni ligjërish e obliguar me ligj ta pyesësh dikë a të bëjë mirë, avokati shtetëror në bazë të Ligjit për Procedurën Jo kontestimore si dhe nenit 67, 68 dhe 70 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive, nuk ka asnjë detyrim të pyes organin e shpronësimit për të lidhë ujdi gjyqësore.*

Në kuptim të autorizimeve dhe përgjegjësiive të avokatit shtetëror Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 10 të Ligjit Nr.04/L-157 Për Avokaturën Shtetërore, me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: 1. Avokatët shtetëror për punën e tyre i përgjigjen Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror. 2. Avokatët shtetëror e informojnë Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror për gjendjen e përfaqësimit të lëndëve. 3. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror ua ndan detyrat avokatëve shtetërorë, dhe iu jep udhëzime të përgjithshme lidhur me kryerjen e detyrave në pajtim me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Avokaturës Shtetërore. Në kuptim të këtij ligji, udhëzimet për punën e avokatëve shtetërorë përfshijnë drejtimit e përgjithshme lidhur me kryerjen e detyrave dhe të aktiviteteve, si dhe orientimet për ndërmarrjen e procedurave dhe të masave në rastet konkrete. 4. Në kryerjen e punëve të përfaqësimit, Avokatura Shtetërore është e autorizuar që të ndërmarr të



*gjitha veprimet të cilat i ndërmerr pala në procedurë, në pajtim me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovë.....”*

Ndërlidhur me këto autorizime të avokatëve shtetërore, Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe përshkrimin e përgjithshëm të detyrave të punës për pozitën e avokatit shtetëror, siç janë:

*- Përfaqëson Avokaturën Shtetërore, në pajtim me autorizimin dhe instruksionet e dhëna nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe është përgjegjës për zbatimin e detyrave të përfaqësimit, këshillimit dhe mbrojtjes sa më të drejtë dhe në mënyrë ligjore, të autoriteteve publikë të Republikës së Kosovës në procedurat gjyqësore të arbitrazhit dhe administrative;*

*- Avokati shtetëror, detyrat e veta i kryen në pajtim me dispozitat ligjore dhe me udhëzimet e dhëna nga Avokati i Përgjithshëm Shtetëror;*

*- Bashkëpunëtorëve profesionale dhe zyrtarëve kontaktues, u jep udhëzime adekuate profesionale, në favor të sigurimit të provave adekuate, përpilimit të shkresave adekuate (padi, përgjigje padi, parashtrësia të ndryshme etj) përkitazi me kontestet konkrete; Varësisht prej situatave, në bashkëpunim me Avokatin e Përgjithshëm mund të kërkojë që përfaqësimet në gjykatë të bëhen së bashku me zyrtarin kontaktues të autoritetit publik, respektivisht të institucionit buxhetor;*

*- Propozon të Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe i përcjellë trajnimet e nevojshme për avokatë shtetëror, bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar kontaktues të autoritetit publik, respektivisht të institucionit buxhetor;*

*Bashkëpunon me institucione dhe autoritete publikë, në funksion të përfaqësimit, këshillimit dhe mbrojtjes, sa më azhure, efikase dhe profesionale të tyre, në procedura gjyqësore, të arbitrazhit dhe administrative;*

*-Propozon ndryshme dhe plotësime të dispozitave ligjore dhe nën ligjore, në drejtim të rregullimit sa më të drejtë dhe funksionale të ushtrimit të funksionit të Avokatit shtetëror, nëpunësve civil dhe të stafit; Kryen edhe punë të tjera në kuadër të kompetencave ligjore.*

Rrjedhimisht, nisur nga baza ligjore si me sipër dhe mbështetur në përshkrimin e detyrave të punës, konstatohet se avokati shtetëror detyrat e veta i kryen në pajtim me dispozitat ligjore si dhe në pajtim me udhëzimet e dhëna nga Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, andaj, mbi këtë bazë të konstatimit, lidhja e ujdive gjyqësore nga ana e ankueses, pa miratim paraprak të Avokates së Përgjithshme Shtetërore, dhe përkundër udhëzimeve të kësaj të fundit, cilësohen si veprime në kundërshtim të plotë me nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “1. Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit”.

Në kontekst të pretendimit ankimor të ankueses se Komisioni Disiplinor ka tejkaluar kompetencat e tij, ngase, shqyrtimi i ujdive gjyqësore është kompetencë e Gjykatës Supreme, Kolegji i Këshillit thekson faktin se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit të goditur me ankesë, nuk ka dhënë konstatim nëse ujdite gjyqësore të lidhura nga ankuesja janë në pajtim apo jo me ligjin material, fakt ky i evidentuar në procesverbalin e Komisionit Disiplinor të datës 28.07.2023, por i njëjti me vendimin e goditur me ankesë ka shpall përgjegjëse ankuesen mbi bazën së e njëjta përkundër kërkesës së Zëvendësueses së Avokatit të Përgjithshme Shtetërore ka lidhë ujdj gjyqësore pa miratimin nga kjo e fundit apo zyrtari i caktuar i Departamentit të Shpronësimit, e si rrjedhojë pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pabazuar.



Me tej, nga provat e kësaj çështje administrative rezultoi se Zëvendësuesja e Avokates së Përgjithshme Shtetërore, më datë 15.02.2023 ka kërkuar nga avokatët shtetëror që çdo vendim gjyqësor të pranuar, ta përcjellin tek organizatat buxhetore. Ndërsa, pas këtij emali dhe bazuar në njoftimet e institucioneve të përfaqësuar rrjedhë se ankuesja nuk kishte dorëzuar vendimet gjyqësore të këto institucione. Gjegjësisht, ankuesja me datë 16.11.2022, kishte pranuar Aktgjykimin Ac.nr.1732/2020 të Gjykatës së Apelit, datë kjo e pohuar nga vet ankuesja pranë Komisionit Disiplinor, mirëpo të njëjtin nuk e kishte përcjell të Shërbimi Korrektuesi Kosovës. Rrjedhimisht, me Aktgjykimin Ac.nr.1732/2020 të Gjykatës së Apelit, ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës Qeveria e Kosovës-Ministria e Drejtësisë dhe është vërtetuar Aktgjykim C.nr.3588/18, i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Sipas këtij të fundit, është detyruar Ministria e Drejtësisë/Shërbimi Korrektues i Kosovës që paditësit t'i bëjë pagesën e pagës jubilarë në shumën e përgjithshme prej 374,00 Euro, kamatën në lartësi prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës në shumë 374.00 €, të gjitha në afat prej 7 ditëve, ndërsa duke qenë se Shërbimi Korrektues nuk ka pranuar aktgjykimin Ac.nr.1732/2020 të Gjykatës së Apelit, paditësi ka kërkuar përmbarimin e Aktgjykimit C.nr.3588/18, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me ç'rast me Aktvendimin Cpc-56/23 Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil ka caktuar përmbarimin e Aktgjykimit C.nr.3588/18, duke obliguar Ministrinë e Drejtësisë që të bëjë kompensimin e pagesave si në aktgjykimin përmbarimor, pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore në shumë prej 117,00 Euro si dhe taksën gjyqësore prej 20,00 Euro.

Po ashtu, pas emalit të datës 12.07.2023 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është vërtetuar se ankuesja nuk kishte përcjell të Ministria e Punëve të Brendshme aktgjykimin A.nr.887/22 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe së ndaj të njëjtit aktgjykim ankuesja nuk kishte parashtruar ankesë. Përkatësisht, sipas aktgjykimit A.nr.887/22 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, e paditura e dytë Ministria e Punëve të Brendshme ishte obliguar që paditësit A. Avdiu ti paguaj kompensimin në mënyrë retroaktive në shumë e përgjithshme prej 6,765.93 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi. Andaj, si pasojë e mos dërgimit të vendimeve gjyqësore të institucionet e përfaqësuar, këto të fundit nuk kanë përbushur detyrimet e tyre sipas këtyre vendimeve dhe njëkohësisht janë shkaktuar edhe shpenzime shtesë buxhetore si rezultat i inicimit të procedurës përmbaruese.

Në këtë aspekt, dhe në vështrim të dispozitave të nenit 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-157 Për Avokaturën Shtetërore, Kolegji vlerëson se funksioni i përfaqësimit nënkupton detyrimin e avokatit shtetëror që si palë në procedurë të ndërmerr çdo veprim në kuptim të mbrojtjes së interesit të institucionit të përfaqësuar, e mbi këtë fakt, mos dërgimi i vendimeve gjyqësore nga ankuesja tek institucionet përfaqësuar si dhe mos parashtrimi i ankesës kundër vendimit gjyqësor të evidentuar si me sipër, në vlerësimin e Kolegjit konsiderohet shmangie nga ushtrimi i detyrave të punës.

Referuar arsyetimit të ankueses lidhu me mos parashtrimin e ankesës kundër aktgjykimit A.nr.887/22, se: *në rastet kur palë në procedurë është KPMSHCK, Avokatia shtetërore nuk merr pjesë në seance gjyqësore, përkatësisht MPB është palë e tretë në këtë rast e drejta e ankesës i takon palës së paditur për të mbrojtur dhe arsyetuar vendimin e vet*, Kolegji sjell në vëmendje dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, sipas të cilit, ankesë ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë mund të parashtrrojë pala e paditur, andaj, duke qenë se në këtë çështje kemi dy të paditur,



KPMSHCK-në si i paditur i parë dhe MPB-në si të paditur të dytë, atëherë, nisur edhe nga fakti së pagesa e obligimeve sipas aktgjykimit në fjalë ka qenë nën detyrimin e të paditurës së dytë, MPB-Avokatia Shtetërore si përfaqësuese e Qeverisë gjegjësisht ankuesja si bartëse e përfaqësueses së çështjes ka poseduar të drejtën e parashtrimit të ankesës kundër Aktgjykimit A.nr.887/22 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Andaj, nisur nga gjendja e fakteve si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton së Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit KD.nr.04/2023 të datës 24.08.2023, i kundërshtuar me ankesë, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë gjendjen faktike dhe ka cilësuar drejtë veprimet e ankuesit si shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.7 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe në këtë mënyrë masa disiplinore e shqiptuar është në pajtim me nenin 50 paragrafin 4 të këtij ligji.

Theksuar si me lartë, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

*Lënda me numër A.nr.1206/2023*

**Avdyl BEKTESHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*



### Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokat
- Zëvendësueses së Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së